



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:066596

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05398886

KPPP.nr. 994/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit K.P.T.Sh. "Autogeni-Ada-Gas Company" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810273409 dhe seli në Gjilan, rr. "Qarkore", p.nr., kundër debitorit "BM Logistic" Sh.P.K., me numër unik identifikues 811450428 dhe seli në Magjistralen Ferizaj – Shkup, p.nr., Ferizaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 206/23, i lejuar me datë 03.05.2023, nga Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 01.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit "BM Logistic" Sh.P.K., me numër unik identifikues 811450428 dhe seli në Ferizaj, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr. 206/23, i lejuar me datë 03.05.2023, nga Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, për pjesën e detyrimit në shumë prej EUR 2,000.00 dhe në këtë pjesë të përbarimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit "BM Logistic" Sh.P.K., me numër unik identifikues 811450428 dhe seli në Ferizaj, ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 206/23, i lejuar me datë 03.05.2023, nga Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, për borxhin në lartësi prej EUR 5,852.89, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. 22-SHV01-002-602 e datës 17.08.2022; Faturës nr. 22-SHV01-002-688,

e datës 08.09.2022; Faturës nr. 22-SHV01-002-930, e datës 31.10.2022, si dhe; Faturës nr. 22-SHV01-002-1070, e datës 30.11.2022, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 206/23, të datës 03.05.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 7,852.89, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e lejimit të urdhrit, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në lartësi prej EUR 104.00.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se lidhur me shërbimet që ka marrë nga kreditori ka paguar me rregull faturat e për të cilat ka dëshmi të transaksioneve bankare. Ka shtuar se me datë 05.04.2023 ka paguar shumën prej EUR 1,000.00, ndërsa me datë 04.04.2023, poashtu shumën prej EUR 1,000.00, duke e pranuar borxhin në shumë prej EUR 5,852.89. Gjykatës i ka propozuar gjykatës që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se procedura përmbartimore është iniciuar në bazë të faturave të cilat i plotësojnë kushtet ligjore, të njëjtat janë në origjinal dhe të nënshkruara. Ka shtuar se debitori ka paguar pjesërisht shumën e faturave, dhe pasi që është lejuar urdhri përmbartimor debitori ka bërë pagesë në shumën prej EUR 2,000.00, ashtu që shuma e borxhit tani e tutje është EUR 5,852.89. Duke qenë se debitori nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tij, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbartimor P.nr. 206/23, i lejuar me datë 03.05.2023, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori dhe atë në lartësi prej EUR 2,000.00, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë pjesë debitori e ka përmbushur detyrimin. Përkatësisht, gjykata gjen se debitori përmes urdhërpaguesës së datës 04.04.2023, ka paguar në llogari të kreditorit vlerën prej EUR 1,000.00, dhe urdhërpaguesës së datës 05.04.2023, ka paguar në llogari të kreditorit vlerën prej EUR 1,000.00, fakt ky i cili është

pohuar edhe nga ana e kreditorit në përgjigje në prapësim, dhe në këtë drejtim prapësimi i debitorit për këtë pjesë të detyrimit është i bazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Meqenëse debitori ka përmbushur pjesërisht borxhin ndaj kreditorit, gjykata në mbështetje të nenit 66, paragrafi 4 të LPP-së, sipas së cilit përcaktohet se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, dhe nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, vendosi që për pjesën e përmbushur të detyrimit në lartësi prej EUR 325.00, procedura përmbarimore të përfundohej.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke e refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr. 206/23, të datës 03.05.2023, për shumën në vlerë prej EUR 5,852.89, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se për pjesën e lënë në fuqi urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht në faturat e përshkruara si në hyrje të arsyetimit të këtij aktvendimi, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre është treguar kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i

faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë në kuptim të nenit 71 të LPP-së për anulimin e tërësishëm të urdhrit përmbarimor, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 994/23, datë 01.03.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.